



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **16.02.2018** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes, **Kryesuesi Dina** – Fillimisht më lejoni të përshëndes Kryetarin e Komunës z. Smajl Latifi, Nënkryetarin e Komunës z. Fatmir Iska, përfaqësuesit e LMT-së, monitoruesit e OSBE-së, përfaqësuesit e mediave, drejtorët e drejtorive komunale, delegatët e kuvendit komunal dhe gjithë të pranishmit. Besoj se rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë? Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Marrja e vendimeve për themelimin e Komiteteve Obligative,
3. Marrja e Vendimit për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-së),
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit të Kryetarit për Shpalljen e Zonës së Interesit të veçantë të parcelës P-71510039-00472-0 në Kramovik, për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza, projekti është financuar nga UNDP-ja,
5. Informatë mbi Thirrjen Publike për Aplikim Nr. 338 të dt. 31.01.2018, për ndarjen e Subvencioneve të DKRS-së,
6. Marrja e vendimit për Formimin e Komisionit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale,
7. Marrja e vendimit për Formimin e Komisionit të Ankesave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale,
8. Marrja e vendimit për pagesën e mëditjeve të gjithë anëtarëve të të gjitha Komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit,
9. Të ndryshme.

Kryesuesi – A ka dikush të shtoj diçka sa i përket rendit të ditës.

Rexhep Oruqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam vërejtje pikërisht në formulimin e rendit të ditës, gjithmonë ka qenë si pikë e dytë e rendit të ditës pyetja: Pyetje dhe përgjigje nga ana e Kuvendarëve, kjo pyetje i ka pasur arsyet e veta për shkak se në këtë kohë janë prezent edhe drejtorët, nuk e di arsyen pse nuk e keni paraparë këtë pikë, prandaj propozimi im është që pika e dytë e rendit të ditës të jetë: Pyetjet dhe Përgjigje nga ana e Kuvendarëve.

Kryesuesi – Meqë është mbledhja e parë kemi menduar që të marrim mendimin e juaj se si do të vendosim, a dëshironi që të jetë si pikë e dytë e rendit të ditës apo si pikë e fundit e rendit të ditës? E qes në votim propozimin e kuvendarit Rexhep Oruqi që si pikë e dytë e rendit të ditës të jetë pyetja: Pyetjet dhe përgjigjet nga ana e

kuvendarëve: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar propozimi i z. Rexhep Oruqi. E qes në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit?

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, mendoj pasi janë mbajtur dy mbledhje, kishte me qenë mirë që të votohen ndaras këto dy procesverbale e jo të votohen si një pako.

Kryesuesi – Në rregull atëherë e qesim në votim procesverbalin e mbledhjes së datës **19.01.2018**: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali i datës 19.01.2018. Tani e qes në votim procesverbalin e datës **20.01.2018**: Konstatohet se 12 pro, asnjë kundër dhe 12 abstenime, si Kryesues sipas ligjit kam të drejtë në këso raste ta shfrytëzoj votën e dyfishtë kështu që vota ime do të jetë pro, prandaj konstatohet se: me 13 vota pro, asnjë kundër dhe 12 abstenime është aprovuar edhe procesverbali i datës **20.01.2018**. Kalojmë në pikën e dytë:

2. Marrja e vendimeve për themelimin e Komiteteve Obligative.

Këtu duhet që të marrim dy vendime njëri për Komitetin për Politikë dhe Financa dhe tjetri për Komitetin për Komunitete, fillimisht kisha kërkuar nga subjektet partiake që janë të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës së Rahovecit që të na japin emrat e shefave të grupeve. Ftojë subjektin e PDK-së që të na jep një emër.

Qazim Qeska – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne si grup i PDK-së dega në Rahovec, propozojmë që udhëheqës i grupit tonë të jetë z. Rasim Fazliu.

Florijs Boshnjaku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne si grup i AAK-së propozojmë për kryesues të grupit z. Ali Morina, me profesion është jurist i njeh çështjet dhe mendojmë se këtë punë do e kryej në bazë të rregullave dhe akteve në fuqi.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Ne si grup i LDK-së propozojmë për kryesues të grupit z. Fehmi Cena.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne si grup i LVV-së propozojmë për kryesues ose shef të grupit parlamentar z. Dervish Qadraku.

Kryesuesi – Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, sa i përket themelimit të KPF-së këtu duhet të respektohet edhe kuota gjinore e cila është obligim sipas një udhëzimi administrativ. Ky komitet ka të drejtë që ti ketë maksimum 7 anëtarë, kështu që subjekti i PDK-së ka të drejtë që ti propozojë dy emra, subjekti AAK-së ka të drejtë që ti propozojë 2 emra, subjekti i LDK-së 2 emra dhe subjekti i VV-së ka të drejtë të propozojë 1 emër. Kishte me qenë mirë që të fillojmë me propozimet e emrave, fillojmë nga subjekti më i madh që është i përfaqësuar në kuvend.

Rasim Fazliu – Ne grupi i PDK-së për anëtarë të KPF-së propozojmë z. Rasim Fazliu dhe z. Rexhep Oruqi.

Ali Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne si grup i AAK-së duke respektuar kuotën gjinore e cila është e obliguar me udhëzim administrativ, propozojmë për anëtar të KPF-së znj. Florijs Boshnjaku, kurse z. Afrim Dina si kryesues i Kuvendit Komunal shkon me automatizëm.

Hanalora Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne si grup parlamentar i LDK-së si përfaqësues të KPF-së propozojmë Dr. Fehmi Cena dhe z. Masar Popaj.

Ali Zhuniqi – Ne si grupe i LVV-së për anëtarë të KPF-së e propozojmë z. Dervish Qadraku.

Florijs Boshnjaku – Në fillim dëgjova që thate se duhet që të respektohet kuota për barazi gjinore, në mandatin e kaluar kur kemi qenë 9 anëtarë kanë qenë 2 gra, arsyetimi ka qenë jo se tani janë 7, kishte me qenë mirë që nga partitë politike të kemi mirëkuptim që mos të na kthehet prapë ky i njëjti vendim në rishqyrtim për arsye që nuk

janë të përfaqësuar gratë në këtë komitet. Më vije mirë që mendojnë për vete por duhet të dinë se edhe të tjerët janë pjesë e këtij kuvendi.

Kryesuesi – Në bazë të udhëzimit administrativ dhe rregullores duhet që të përmbushet kuota gjinore, dua që të ju njoftoj se me datë **07.02.2018** kam marrë pjesë në kolegjiun e Asociacionit të Komunave të Kosovës ku na ceken që MAPL-ja i ka kthyer vendimet disa komunave, arsyeja ka qenë mos respektimi i kuotës gjinore, prandaj kisha bërë një thirrje që të reflektoni në mënyrë që mos të na kthehet vendimi edhe neve.

Fehmi Cena – A është kjo e domosdoshme apo ndoshta respektimi i kuotës gjinore përfshinë të gjitha komitetet dhe komisionet e formuara, apo bëhet fjalë vetëm për KPF-në, pra nëse është detyruese është diçka tjetër, por nëse është rekomandim nuk do të thotë që duhet patjetër.

Kryesuesi –I nderuar z.Fehmi Cena kjo është detyruese për të gjitha komitetet dhe komisionet duhet që të respektohet kuota gjinore.

Rasim Fazliu – Ne si grup i PDK-së kemi pasur kujdes në këtë çështje prandaj në Komitetin për Komunitete kemi paraparë që të propozojmë gjininë femërore.

Kryesuesi – Kisha kërkuar që të na jep një sqarim shefi i zyrës ligjore z.Isak Hoti.

Isak Hoti, Shef i zyrës ligjore – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, jo vetëm në komitetet obligative por edhe komitetet e tjera dhe komisione është obligative që të respektohet kuota gjinore në bazë të ligjit për barazi gjinore, nëse mirret një vendim dhe aty janë 7 anëtarë atëherë duhet të jenë 4 femra dhe 3 meshkuj ose anasjelltas, asnjë komitet ose komision nuk do të kalojë në MAPL nëse nuk përfaqësohet përfaqësimi gjinor përmes kuotës edhe pse bien ndesh ligji për zgjedhjet ku thotë se duhet të jetë 30%, por ligji për barazi gjinore është duke u marrë për bazë për arsye se është duke e paraparë 50 % me 50 %.

Kryesuesi – A do të ndryshojnë ndonjë emër të kandidatit ndonjë subjekt ose do të qesim në votim ashtu siç i keni propozuar.

Masar Popaj – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, për hir të asaj që ju e thatë unë do të tërhiqem si kandidat i propozuar për anëtar të KPF-së, në vend timin e propozoj znj.Fahrije Lushi-Morina për anëtare të KPF-së.

Kryesuesi – Po i lexoj edhe një herë emrat e propozuar për KPF nga subjektet partiake, PDK-ja ka propozuar z. Rasim Fazliun dhe z Rexhep Oruqin, AAK-ja ka propozuar z.Afrim Dina dhe znj.Florije Boshnjaku, LDK-ja ka propozuar z. Fehmi Cena dhe znj.Fahrije Lushi-Morina kurse LVV ka propozuar z. Dervish Qadraku.

I qes në votim emrat e propozuar për anëtarë të KPF-së: Konstatohet se në mënyrë unanime janë aprovuar emrat e propozuar për anëtarë të KPF-së. Vazhdojmë me themelimin e Komitetit për Komunitete, në këtë komitet kanë të drejtë të jenë 5 – 9 anëtarë, mbetet tek ju tani që të vendosni se sa anëtarë do të ketë ky komitet.

Rasim Fazliu – Konsideroj se është e mjaftueshme që të shkohet edhe me 7 anëtarë për Komitetin për Komunitete, por për ne nuk prish asgjë edhe nëse shkohet me 9 anëtarë në mënyrë që të plotësohet kuota gjinore.

Florije Boshnjaku- Faleminderit Kryesues, është e ditur që në Komitetin për Komunitete shumica e anëtarëve do të jenë nga komuniteti jo shumicë , pra nëse janë 4 anëtarë nga komuniteti jo shumicë atëherë ne mund të përfaqësohemi vetëm me tri parti politike në këtë komitet , këtu qëndron çështja por e theksoj prapë si të vendosin shumica nuk paraqet ndonjë problem , nëse ka ndonjë udhëzim ose rregullore ne do të pajtohemi edhe pse po të ishte me 9 anëtarë në përbërje ky komitet do të ishte më mirë sepse do përfaqësohemi ne 4 partitë politike si dhe 5 anëtarë nga komuniteti jo shumicë ashtu siç edhe është e paraparë me ligj.

Trajko Shariq- Pajtohem me zonjën e cila tha që është mirë të jenë 9 anëtarë brenda këtij komiteti, duke e marrë parasysh që edhe mandatin e kaluar kanë qenë 9 anëtarë, arsyetimi im është që 4 anëtarë të cilët janë emëruar nga

komuniteti jo shumicë duhet të jenë përfaqësues, edhe unë si anëtar i Kuvendit Komunal me automatizëm jam anëtarë i Komitetit për Komunitete.

Dervish Çadraku- Përshëndetje për të gjithë, ndoshta ka qenë më mirë që të shpjegohen kriteret pse ndodhin përfaqësimet me kaq apo me aq kandidatë sepse shumica prej nesh janë anëtarë të Kuvendit për herë të parë dhe shumë rregulla nuk i dinë sepse se kanë as profesion në fund të fundit, prandaj ka qenë mirë që të shpjegohen cilat janë kriteret e përfaqësimit në këtë Komitet, nëse kërkohet nga unë atëherë them që është e mjaftueshme me 7 anëtarë.

Kryesuesi- Faleminderit, kisha kërkuar nga zyra ligjore që të na japë ndonjë sqarim ose informacion shtesë.

Isak Hoti- Në bazë të udhëzimit administrativ të MAPL-së me numër 03/2014 për procedurën e themelimit përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme të komunave thotë: Në nenin 7 ceket numri i anëtarëve të KPF-së duhet të jetë në proporcion nga fuqia e votave të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, kjo është e specifikuar decidivisht. kurse sa i përket Komitetit për Komunitete neni 9 tek përbërja e Komitetit për Komunitete ceket: Komiteti për komunitete përbëhet nga anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesit e Komuniteteve. Komiteti për Komunitete përfshin anëtarët e Komuniteteve jo shumicë të përfaqësuar nga Kuvendi i Komunës jashtë tij gjë që edhe Komiteti për Komunitete e zgjedhin vetë kryesuesin dhe e udhëheqin vetë Komitetin, në rastin tonë i kemi tre delegatë e nëse komiteti do përbëhet me 9 anëtarë atëherë shkojnë 4 anëtarë nga subjektet politike pjesa tjetër e mbetur i takon Komunitetit jo shumicë që jetojnë brenda territorit administrativ të Komunës së Rahovecit do të thotë nëse ne i dërgojmë 4 anëtarë pjesa tjetër është e Komuniteteve nëse nuk gabojmë janë diku 3 deri 4 komunitete, kjo është përbërja që duhet të jetë në Komitet, pra kjo është obligative jo rastësisht e thash se është obligative me udhëzim administrativ, përfaqësimi gjinor edhe tek Komiteti për Komitete edhe tek KPF-ja duhet të jetë në proporcion me përfaqësimin e tyre në Kuvendin e Komunës, pra është obligative respektimi i barazisë gjinore.

Dervish Qadraku – Isha i interesuar që ta di përbërjen e komiteteve, numri i tyre dhe cili kushti i domosdoshëm për me pas numrin e caktuar.

Isak Hoti – Tek neni 10 te i njëjti udhëzim administrativ ceket: Zgjedhja e anëtarëve të Komitetit për Komunitete bëhet me propozimet e anëtarëve të propozuar nga komuniteti jo shumicë, kurse miratimi bëhet nga Kuvendi i Komunës. Është një formular ku i mbledhin nënshkrimet e banorëve të vendbanimeve të tyre, pastaj atë formular e sjellin në Komunë, pastaj futen në votim në Kuvend. Është obligative që secili komunitet të përfaqësohet pavarësisht numrit të tyre. Në web faqe të MAPL-së e keni një udhëzues se si formohet Komiteti për Komunitete për shkak të dilemave që keni pasur në ligjin për vetëqeverisje lokale edhe për rregulloren ka qenë njëjtë është bërë një udhëzues se si të formohet Komiteti për Komunitete, mos të harrojmë se edhe këtu përfaqësimi gjinor është i domosdoshëm. Edhe një sqarim Komunitetet propozojnë përfaqësuesit e tyre në Komitet me kusht që ata të mos jenë edhe anëtarë të Kuvendit Komunal, nëse ndonjëri nga Komunitetet është kuvendar në këtë rast nuk ka të drejtë të jetë anëtar i Komitetit për Komunitete, kjo është e ndaluar decidivisht me udhëzues.

Kryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, nëse kërkohet opinioni im si Kryetar Komune mendoj se nuk është fare gabim edhe nëse shkojmë që të jenë 9 anëtarë në Komitetin për Komunitete, arsyet janë thjeshtë praktike dhe në këtë mënyrë përfaqësimi në këtë Komitet do të jetë më i mirë sepse interesat, nevojat, kërkesat, shqetësimet do të adresohen në këtë komitet, prandaj nuk besoj që është ndonjë pengesë nëse janë 9 anëtarë.

Kryesuesi – Pasi patëm dy propozime atëherë qesim në votim propozimin që Komiteti për Komunitete të përbëhet nga 9 anëtarë: Konstatoj se është aprovuar propozimi që Komiteti për Komunitete të përbëhet nga 9 anëtarë. Meqë

shumicën e përbëjnë komunitetet atëherë Kuvendi duhet ti propozojë 4 anëtarë, 4 partitë më të mëdha politike do të propozojnë nga një anëtarë, edhe këtu duhet që ti përmbaheni kuotës gjinore. Shkojmë me propozime:

Rasim Fazliu – Ne si grup parlamentar i PDK-së në Komitetin për Komunitet propozojmë znj. Florida Bajraktari.

Ali Morina – Ne si grup parlamentar i AAK- së në Komitetin për Komunitete propozojmë znj. Bjondina Kleqka.

Fehmi Cena – Ne si grup parlamentar i LDK-së në Komitetin për Komunitete propozojmë znj. Mirjeta Krasniqi.

Dervish Qadraku – Ne si grup parlamentar i LVV-së në Komitetin për Komunitet propozojmë z. Ali Zhuniqi.

Kryesuesi – Propozimet që na kanë ardhur nga Komuniteti jo shumicë që të jenë përfaqësues të Komitetit për Komunitete janë këta: znj. Aleksandra Vecevic nga komuniteti serb, z. Darko Antic nga komuniteti serb, z. Bajram Morina nga komuniteti ashkali, z. Bujar Morina nga komuniteti egjiptian, z. Ramë Berisha nga komuniteti romë.

Kryetari – z. Bajram Morina dhe z. Bujar Morina që të dy janë nga fshati Ratkoc po ashtu janë edhe kushërinj, prandaj propozimi im është që të mbetet vetëm z. Bajram Morina dhe në këtë Komitet të përfaqësohen tre anëtarë nga Komuniteti serb dhe dy nga komunitete tjera, kështu ka qenë edhe në të kaluarën. Nënshkrime mund të mbledhë çdo kush por nuk besoj që ka nevojë që të jenë pjesë e këtij Komiteti dy persona të cilët kanë afërsi fafësnore njëri me tjetrin.

Trajko Shariq – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, nuk jam për atë që vetëm dy anëtarë nga komunitetet tjera të përfaqësohen në Komitetin për Komunitete, por pasi që më ndalon udhëzimi administrativ mua si anëtar i Kuvendit Komunal që të jem pjesë e këtij Komiteti atëherë është mirë që tre anëtarë nga komuniteti serb do të përfaqësohen në Komitetin për Komunitete.

Kryesuesi – I nderuar a keni ndonjë emër që të propozoni si anëtarë të tretë nga Komuniteti serb që të jetë pjesë e Komitetit për Komunitete?

Trajko Shariq – Nuk mundem të ju jap tani për tani emrin edhe pse unë e kisha propozuar z. Nebojsa Antiq, por ky ka lidhje fafësnore me z. Darko Antiq dhe nuk e di a është e pranueshme që të jenë të dy pjesë e këtij komiteti. Nëse ka mundësi do e sjell emrin dikur më vonë, nëse jeni të pajtimit edhe ju.

Kryesuesi – Të nderuar kuvendarë a jeni të pajtimit që një emër nga Komuniteti serb të na vijë më vonë?

Rasim Fazliu – I nderuar Kryesues Kryetari i Komunës më duket që pak më parë e ceku se z. Bujar Morina dhe z. Bajram Morina kanë lidhje fafësnore por ju nuk na treguat se cili nga këta të dy emra do të jetë pjesë e Komitetit për Komunitete, e pastaj mund ta qesësh në votim.

Kryesuesi – I nderuar z. Rasim Fazliu, z. Bujar Morina eliminohet dhe mbetet z. Bajram Morina.

Trajko Shariq – Emërimi i anëtarëve të Komitetit për Komunitete që nuk janë anëtarë të Kuvendit po ju njoftoj se është bërë në bazë të nënshkrimeve që i kanë marrë nga Komunitetet e tyre, është mirë që të dimë se kush ka marrë më shumë nënshkrime nga Komuniteti i tyre z. Bujar Morina apo z. Bajram Morina.

Kryesuesi – I nderuar z. Shariq sa për informatë ne i kemi këtu listat e nënshkrimeve dhe po ju njoftoj se më shumë nënshkrime ka z. Bajram Morina.

Dervish Qadraku – I nderuar Kryesues këta dy zotërinjtë që i përmendët a i përfaqësojnë dy Komunitete ?

Kryesuesi – I nderuar z. Qadraku sa për informatë z. Bajram Morina përfaqëson Komitetin ashkali, kurse z. Bujar Morina përfaqëson Komitetin egjiptian.

Dervish Qadraku – I nderuar Kryesues këta dy përfaqësojnë Komunitete të ndara, nuk ka kurrfarë pengese që këta të dy janë kushërinj mes vete. Nëse është pengesë kjo atëherë kjo le të vlejë edhe për Komunitete tjera.

Kryesuesi - Të nderuar kuvendarë po ju lexoj emrat e propozuar për anëtarë të Komitetit për Komunitete.

Nga radhët e PDK- së është propozuar znj. Florida Bajraktari, nga radhët e AAK-së znj. Bjondina Kleqka, nga radhët e LDK-së është propozuar znj. Mirjeta Krasniqi, nga radhët e LVV-së është propozuar z. Ali Zhuniqi, kurse nga Komunitetet jo shumicë na kanë ardhur këta emra: Nga komuniteti serb znj. Aleksandra Veçeviq, z. Darko Antiq, nga Komuniteti romë- ashkali z. Ramë Berisha, kurse nga Komuniteti egjiptian z. Bajram Morina. I qes në votim këto propozime: Konstatohet se me 1 abstencion dhe të tjerët pro janë aprovuar emrat e propozuar për anëtarë të Komitetit për Komunitete. Kalojmë në pikën e radhës:

3. Marrja e Vendimit për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS-së).

Sa i përket kësaj pike ne kemi shpallur një thirrje publike për të aplikuar për anëtarë të KKS-së, Këshilli Komunal për siguri në Bashkësi përbëhet nga këta anëtarë: Kryetari i Komunës, Komandanti i Stacionit të Policisë në Komunën përkatëse, një përfaqësues i secilës bashkësi fetare të Komunës përkatëse, një përfaqësues i secilit Komunitet etnik të Komunës përkatëse, një zyrtar për gjinore, Drejtori i Drejtoratit për Arsim, Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës përkatëse, një përfaqësues i FSK-së, një përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike, kryesuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale, një përfaqësues i OJQ-ve, përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, një përfaqësues i mediave lokale, një përfaqësues i komunitetit të biznesit dhe një përfaqësues i komunitetit të personave me aftësi të kufizuara (PAK). Në KKS Kryetari i Komunës emërohet automatikisht, Komandanti i stacionit policor po ashtu automatikisht, Bashkësia Islame në Rahovec ka deleguar për anëtar të KKS-së z. Nysret Abazibra krye imam i KBI-së në Rahovec, Teqeja e Madhe e “Shejh Sylejmani” në Rahovec ka deleguar z. Ylvi Shehu, Teqeja e “ Haxhi Shejh Iljaz Shehu” në Rahovec ka deleguar z. Sabahudin Durguti, Kisha ortodokse serbe në Rahovec delegon z. Velja Stojković, Komuniteti egjiptian delegon z. Bujar Morina, Komuniteti romë - ashkali delegon z. Ramë Berisha, Komuniteti serb delegon znj. Aleksandra Veçeviq, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete emërohet me automatizëm pasi që të zgjidhet, zyrtari për barazi gjinore z. Ekrem Bytyqi, Drejtori i DKA-së z. Avni Morina, Anëtar i këshillit të prindërve z. Ymret Reshiti, Përfaqësuesi i FSK-së z. Xhavit Kelmendi, Këshilli Lokal për siguri publike delegon z. Enis Berisha, Ekipi veprues për siguri në bashkësi delegon z. Beqir Hamza, Përfaqësues nga sektori i emergjencave civile komunale emërohet Drejtori i Drejtorisë për Emergjencë dhe Shpëtim z. Hasan Përboqi, Përfaqësues nga OJQ-të, kemi një propozim nga Qendra Rinore në Rahovec ku propozon znj. Sihane Duraku, po ashtu kemi edhe një propozim nga OJQ-ja OPFAK ku propozon z. Lulzim Krasniqi, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim emërohet automatikisht z. Jovan Bojiq, Përfaqësues nga mediat lokale propozohet z. Shaip Shala, Përfaqësues nga Komuniteti i Bizneseve propozohet z. Fadil Sylka, Përfaqësues i Komunitetit të personave me aftësi të kufizuara propozohet z. Haxhi Hoxha përfaqësues i Hendikosit.

Rasim Fazliu – I nderuar Kryesues në listën të cilën na keni shpërndarë me material nuk figuron emri i z. Lulzim Krasniqi.

Kryesuesi - I nderuar z. Rasim Fazliu ky emër na ka ardhur pasi që ju kemi dërguar materialin, pra ka ardhur me vonesë.

Munib Durguti – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, edhe në të kaluarën e kam potencuar që është shumë e arsyeshme dhe e nevojshme që në kuadër të KKS-së të përfshihet edhe një anëtar nga Qendra për Punë Sociale, për faktin se kur fokusohemi tek detyrat dhe përgjegjësitë e KKS-së një punëtor social është shumë i nevojshëm, në rastet e deliktit të nxënësit fillimisht ftohet një punëtor social tek pastaj vjen në shprehje policia, mendoj që raportet e punëtorëve socialë do të kontribuonin jashtëzakonisht shumë në punën e këtij këshilli, qoftë drejtori ose një punëtor që është në terren që ofron shërbime sociale.

Kryesuesi – Të nderuar Kuvendarë e qesim në votim propozimin e z. Munib Durguti, që një anëtarë i KKSBB-së të jetë nga Qendra për Punë Sociale.

Florijs Boshnjaku – I nderuar Kryesues do të ndalem edhe një herë sa i përket barazisë gjinore, pasi që po e shoh që shumica e anëtarëve të propozuar janë burra, andaj propozoj znj. Goneta Mustafa punëtore e Qendrës për Punë Sociale nëse edhe ju pajtoheni që edhe ajo të jetë pjesë e KKSBB-së, është mirë që të jetë pjesë e këtij këshilli edhe për shkak të barazisë gjinore po ashtu ka përvojë të gjatë rreth 20 vite punë besoj se kishte me kontribu shumë në këtë këshill.

Kryesuesi – E qesim në votim propozimin e znj. Florijs Boshnjaku që znj. Goneta Mustafa të jetë pjesë e KKSBB-së: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar propozimi i zn. Florijs Boshnjaku.

Tani të nderuar kuvendar i qes në votim emrat e anëtarëve të KKSBB-së: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar lista me emrat e propozuar të anëtarëve të KKSBB-së.

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit të Kryetarit për Shpalljen e Zonës së Interesit të veçantë të parcelës P-71510039-00472-0 në Kramovik, për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza, projekti është financuar nga UNDP-ja.

Ftoj Nënkryetarin e Komunës z. Fatmir Iska që të na jep një sqarim më të hollësishëm rreth kësaj pike.

Nënkryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ky është një projekt i cili financohet nga UNDP-ja, ne këtu e kemi prezent edhe përfaqësuesin e UNDP-së i cili është marrë me këtë projekt, këtu kemi të bëjmë me ndërtimin e impiantit për ujërat e zeza, nëse e shihni të nevojshëm që të elaboroj këtë projekt në detaje se si do të funksionojë ky projekt mundemi të ja japim fjalën edhe përfaqësuesit të UNDP-së, këtu ka të bëjë me një parcelë ose ngastër tokësore në fshatin Kramovik, ne kemi ndarë një ngastër tokësore me nr. të parcelës 472 zona kadastrale në Kramovik, hapësira e saj në total është 92 ari 47 m², por për këtë projekt janë të mjaftueshëm vetëm 30 ari, kemi edhe një kërkesë e cila është shqyrtuar edhe nga ish Kryetari i Komunës z. Idriz Vehapi, më herët ka qenë kërkesa për dy parcela të tjera, por problemi ka qenë tek një parcelë e cila ka qenë në mes të këtyre parcelave dhe ajo ka qenë parcelë private dhe kanë kërkuar shpronësim, ku është dashur të shkojmë përmes disa procedurave, për mos zgjatjen e kësaj pune ne i kemi hyrë një opsioni tjetër dhe e kemi gjetë këtë lokacion që mendojmë se është më i përshtatshëm për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza. Besoj se e keni edhe ju në material pëlqimin e qytetarëve të fshatit Kramovik, ne si ekzekutiv kemi pasur takim edhe me Kryetarin e Këshillit të fshatit Kramovik, që të jemi më të qartë në çertifikatën e pronësisë në faqe nr. 2 shkruan se shfrytëzimi aktual i parcelës është varreza, në fakt nuk ka varreza aty sepse ekipi i gjeodetëve ka dalë në vendin e ngjarjes ku jemi takuar edhe me Kryetarin e Bashkësisë Islame në Rahovec ku kemi kërkuar pëlqimin edhe të Bashkësisë Islame për ndërtimin e këtij impianti, i kuptoj procedurat që është dashur kjo të kalojë edhe në KPF, por dua të ju bëjë me dije se problemi qëndron tek ajo se projekti duhet sa ma parë të fillojë dhe nuk kemi kohë. Të gjitha kostot e këtij projekti i bartë UNDP-ja, kostoja e Komunës në këtë projekt është zero, nga ju kërkohet që kjo parcelë të shpallet si interes i përgjithshëm në mënyrë që mos të vonohet UNDP-ja me shpalljet e procedurave të tenderimit për arsye se komplet ky projekt duhet të përfundojë brenda vitit, nëse nuk përfundon kjo –punë brenda këtij viti atëherë komplet projekti do të dështoj. Kjo është në interes të Komunës dhe qytetarëve të Kramovikut, besoj se kesi projekte të kësaj natyre do të ndodhin edhe në lokalitetet e tjera të Komunës sonë vetëm se kërkohet bashkëpunim me UNDP-në. E ftoj përfaqësuesin e këtij projekti nga UNDP-ja z. Lavdim Osmani që të ju jep sqarime rreth këtij projekti.

Rasim Fazliu – Personalisht unë i nderuari Kryesues por besoj se edhe grupi im e përshëndesim këtë iniciativë, ku të marrim dhe të ndërtojmë sa ma shumë impiante që të kemi një natyrë më të pastër edhe ujërat edhe tokën, është

gjë e mirë por pyetja ime është: A pajtohet i tërë Komuniteti i Kramovikut, mos të na del në të ardhmen ndonjë problem, nënshkrimet i keni marrë por nënshkrimet nuk e përfaqësojnë tërë Komunitetin, tjetra është nëse nuk gabohet në qeverisjen e kaluar kemi pasur projekte që të ndërtohen impiante gjithëpërfshirëse matanë Gradishit të ndërtohet një impiant ku do të përfshihen të gjitha fshatrat e asaj ane, po ashtu e njëjta vlen edhe për Krushën e Madhe. Si përfundim po them ky impiant a do ta përfshijë vetëm fshatin e Kramovikut apo do të përfshihen edhe fshatrat e tjerë përreth. Ne nuk kemi asgjë kundër kësaj iniciative përpos asaj që e thash se a keni menduar që të ndërtohet një impiant gjithëpërfshirës andej Gradishit dhe gjithëpërfshirës këtej Gradishit.

Fatmir Iska – Po ju përgjigjem në pyetjen e parë, i nderuari z. Rasim Fazliu ju e dini sepse keni qenë pjesë e komisionit për përzgjedhjen e këshillave të fshatit, ne jemi takuar edhe me Kryetarin e fshatit, Kryetari i fshatit së bashku me kryesinë e tij është i pajtimit që kjo punë të bëhet ai po ashtu ka marrë iniciativë që të mbledhë këto nënshkrime që ju sot i keni para vetes po ashtu meqenëse është ai Kryetari i fshatit besoj se e ka pëlqimin e të gjithë banorëve. E përmenda më parë edhe një pëlqim nga Bashkësia Islame, e treta kjo iniciativë ka qenë edhe vullneti i ish Kryetarit të Komunës z. Idriz Vehapi që kjo punë të bëhet, pra iniciativa ka rrjedhë edhe nga mandati i kaluar që të bëhet kjo në mënyrë që mos të dështoj projekti. Ky projekt do të ndërtohet në këtë lokalitet por ai kolektori i madh i cili do ti trajtojë ujërat e zeza në nivel komunal është një projekt më i madh i cili besoj se do të ndërtohet në vitet e ardhshme po duke mos harruar se ky projekt ka një kosto të madhe, të gjithë e dini që ne si Komunë kemi hyrë në një obligim ose marrëveshje me një kompani Austriake me garanci të qeverisë, por kjo punë do të ndodhë besoj më vonë. Mendoj se nuk është mirë të dështoj një projekt i cili është në interes të qytetarëve të Komunës sonë, prandaj mendoj se është shumë e arsyeshme që ju si delegatë me e përkrah këtë propozim.

Lavdim Osmani, konsulent i UNDP-së – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, UNDP-ja ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi qysh para një viti me Komunën e Rahovecit, por procedurat si të UNDP-së ashtu edhe të organizatave të tjera nuk janë proceduara të shpejta të cilat përfundojnë brenda një periudhe të caktuar, ky projekt u ndërpre si proces për shkak të zgjedhjeve që ka pasur vendi ynë. Është hartuar projekti detal vetëm për fshatin Kramovik dhe ky projekt është në interes vetëm për banorët e fshatit Kramovik, në këtë projekt nuk përfshihen fshatrat e tjera ky është një pilot projekt, por ajo që është shumë e rëndësishme është se për herë të parë është duke u bërë një pilot projekt i tillë me fondet e Kombeve të Bashkuara sepse Kombet e Bashkuara akoma nuk e njohin Kosovën si shtet, UNDP-ja e ka fituar këtë projekt në bazë të një memorandumit që ka pasur me shtetet e rajonit ku e ke fituar edhe Kosova. Parcela e cila kërkohet të aprovohet urgjentisht nga ana e juaj është për arsye që të filloj procedura e tenderimit, të gjithë e dini se procedurat e tenderimit vonohen, por në UNDP ka një hierarki dhe minimum 2 muaj zgjatë deri sa e lidhim një marrëveshje me ndonjë punë kryes. UNDP-ja i ka marrë përsipër të gjitha obligimet financiare në këtë projekt Komuna nuk ka kurrfarë obligimi financiar, mirëmbajtjen e këtij projekti në të ardhmen do ta bëjë Kompania e Radoniqit e cila me ligjet e Kosovës është e thirrur për mirëmbajtje, kaq për momentin kush do që ka nevojë për sqarime të mëtutjeshme jam këtu për të ju përgjigjur.

Dervish Qadraku – Fillimisht desha të ju pyes se sa është kostoja e këtij projekti?

Lavdim Osmani – Kostoja është rreth 100,000.00 €, harrova edhe diçka me ju cek se në fund të muajit shtator apo në fillim të muajit tetor do të vijë një Komunitet diku rreth 100 persona ku do ta vizitojnë këtë fshat, prandaj arsyeja ka qenë që të bëhet një projekt i këtillë që në të ardhmen edhe në fshatrat e tjera të ndërtohen këso projekte.

Dervish Qadraku – Materiali i cili na është dërguar neve i ka dy terme, njëri term është impiant kurse termi tjetër është gropë septike, pyetje ime është: Ky projekt a është gropë septike apo impiant?

Lavdim Osmani – Ky projekt është për trajtim të ujërave të zeza komfor ligjeve dhe rregulloreve në fuqi të Republikës së Kosovës, besoj se të gjithë e dini se çka është gropë septike, ky projekt është për ndërtimin e një impianti e jo gropë septike.

Dervish Qadraku – Cili ka qenë kushti që e ka fituar këtë projekt fshati Kramovik?

Lavdim Osmani – Ka qenë një zgjedhje e pilot projektit nga ura e Gjonajt e deri tek pjesa e fshatit Kramovik, ky ka qenë një propozim i MMPH, konkretisht ministrit z. Ferid Agani, kjo është bërë për shkak të shfrytëzimit të zhavorrit në atë pjesë.

Dervish Qadraku – Mendoj se fillimisht duhet neve si anëtarë të Kuvendit të na tregohet se sa është largësia nga fshati i këtij impianti, pra nga banorët që frekuentojnë. E dyta pse nuk ka ndikuar Komuna që këtë impiant që unë e kam shumë me dyshim ta sjellin në Rahovec ose Krushë të Madhe , Xërxë dhe të bëhet në një vend sepse Kramoviku si Komunitet është shumë i vogël dhe ndotja e ambientit është shumë më e vogël se sa e qytetit ose të fshatrave që kanë nga 3000 – 4000 banorë. Kush ka ndikuar që ky projekt të shkoj në Kramovik edhe pse shumë mirë ka bërë që ka shkuar në këtë fshat por më mirë mendoj kishte me qenë që trajtimi i ujërave të zeza të bëhet në qytetin e Rahovecit sepse këtu kemi podrumë të shumta për prodhim të rakisë dhe verës, pastaj ka banorë më shumë dhe me këtë rast kemi më shumë ndotje të ambientit.

Kryetari – Të nderuar kuvendarë MMPH dhe qeverisja e kaluar sigurisht kanë gjetur modalitetet e veta që e kanë zgjedhur Kramovikun si një ndotës i madh i ambientit ose shkatërrues i mjedisit për shkak të eksploatimit. Ne e kemi trashëguar këtë projekt nga mandati i kaluar dhe nuk dëshirojmë që ky pilot projekt i fituar nga Komuna jonë për arsye objektive ose subjektive të mos e gjejë rrugën e realizimit të vet. Besoj se zgjidhjen që ja ka dhënë ky Kuvend nga kuvendarët e kaluar nuk ka qenë e mjaftueshme për shkak siç e tha edhe Nënkryetari këto dy prona janë komunale kurse një pronë është private por aty ishte edhe një rrugë, besoni se unë e njoh shumë mirë këtë problematikë. Ne nga konsulenti i UNDP-së kemi marrë jo vetëm sugjerim por edhe rekomandim se nuk mundet, po ashtu kemi marrë vërejtjet nga Këshilli i Fshatit por edhe nga Komuniteti i Kramovikut, nëse ne e vendosim këtë impiant aty jo vetëm që duhet të bëhet shpronësimi i kësaj parcele por duhet të dini që vendi është tejet i papërshtatshëm sepse është rrugë ku qarkullojnë banorët sepse është afër vendbanimit dhe pikërisht ky opsion i dytë që kërkohet sot të aprovohet nga ana e juaj i plotëson të gjitha kushtet që impianti të vendoset aty dhe të jetë funksional. Shpresoj se në bashkëpunim me ju dhe duke treguar që jemi storie e suksesit si Komunë atëherë UNDP-ja mundet të merr përsipër në bashkëpunim me Komunën e Rahovecit dhe MMPH edhe projekte të tilla jo vetëm pilot projekte por të vazhdoj edhe me projekte të tilla në ndërtimin e impianteve të cilat do të zgjidhin përfundimisht problemin e ujërave të zeza në zonat ku vendosen, ku të marrim dhe të ndërtojmë një impiante të madh për trajtimin e ujërave të zeza, por besoj se edhe ndërtimi i impianteve të vogla është një zgjidhje afatgjate. Edhe një herë ju ftoj që të përkrahni këtë projekt, ne si Komunë ju kemi përfillur të gjitha rregullave të lojës, kemi takuar Komunitetin, po ashtu edhe UNDP-ja ka takuar Komunitetin, ne po e vazhdojmë një projekt të qeverisë së kaluar megjithatë është një projekt i UNDP-së ku besoj se duhet që të jeni bukur të pa matur që mos ta votoni sepse është në interes të një Komuniteti të caktuar në këtë rast të fshatit Kramovik.

Fehmi Cena – Sigurisht që ne si grup i LDK-së e përkrahim këtë projekt sepse është në interes jo vetëm të fshatit Kramovik por është në interes të gjithë qytetarëve, ky është një pilot projekt dhe ne e kuptojmë se çka është pilot projekt, është një projekt i vogël fillestar ku ne të gjithë do të mësohemi pastaj që ti bëjmë këto projekte si duhet, besoj se ky projekt do të ketë ato standarde tamam si duhet ashtu si në përfundim. Falënderoj UNDP-në e cila në

këtë rast e ka bërë këtë donacion, sigurisht kërkoj që edhe komuna jonë në të ardhmen të ketë parasysh dhe të merë pjesë në impiante të tjera në mënyrë që të gjitha fshatrat edhe qyteti në të ardhmen me i kyç të gjitha kanalizimet në impiante në mënyrë që ujërat tonë të jenë sa më të pastër.

Munib Durguti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha vetëm një sqarim sepse përfaqësuesi i UNDP-së nuk na dha sqarime rreth këtij impianti se si do të funksionoj ky implant, përndryshe unë personalisht kam qenë i kyçur në fazën e parë në këtë projekt me ish ministrin z. Ferid Agani, në atë kohë na është thënë se ky është një pilot projekt që nuk është ndërtuar në këtë rajon përveç se në Slloveni, në Slloveni këto impiante gjejnë zbatim të madh, këtu bëhet fjalë për një implant natyror i cili përmes disa shtresave të zhavorrit dhe disa kombinimeve tjera ndërtohet dhe krejt në fund mbjellin disa fidanë që ta mbrojnë atë zonë. Ky implant i ka dy role nëse bëhet fjalë këtu për implantin që unë jam në dijeni, roli i parë është riciklimi i ujërave, pastrimi i ujit para se të derdhet në lumin Drinin e Bardhë, kurse roli i dytë është mbrojtja e mjedisit pra do të pamundësojë eksplantimin e zhavorrit i cili e rrezikon jashtëzakonisht këtë ambient. Vetëm dua një sqarim a kemi të bëjmë me implantin të cilin unë fola deri tani apo kemi të bëjmë me ndonjë implant tjetër?

Lavdim Osmani – Pikërisht është një implant i tillë, kërkoj falje që nuk e kam dokumentuar me një përshkrim teknik, në këtë material që e keni ju sot para vete unë kam menduar se ka qenë më shumë pjesë teknike dhe nuk dëshironi më shumë të thelloheni. Pikërisht ky projekt është i nderuari z. Durguti i cili ka filluar në kohën kur ishte ministër z. Ferid Agani i cili u përkrah fuqishëm nga ish Kryetari z. Idriz Vehapi dhe tani është në tavolinën e juaj.

Kryesuesi – E qes në votim pikën e katërt të rendit të ditës Shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit të Kryetarit për Shpalljen e Zonës së Interesit të veçantë të parcelës P-71510039-00472-0 në Kramovik, për ndërtimin e implantit të ujërave të zeza, projekti i financuar nga UNDP-ja : Konstatohet se në mënyrë unanime është votuar pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

5. Informatë mbi Thirrjen Publike për Aplikim Nr. 338 të dt. 31.01.2018, për ndarjen e Subvencioneve të DKRS-së.

Ervin Hoxha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në mbështetje të nenit 4 lidhur me nenin 13 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 5 lidhur me nenin 12 dhe 22 të Rregullores për Kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017, për destinimin e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, më 31 janar 2018 ka publikuar thirrjen për aplikim të OJQ-ve me plane e projekte që do të mbështeten gjatë vitit 2018. Afati për aplikim është mbyllur më 14 shkurt 2018. Përmes kësaj thirrjeje janë ftuar të gjitha OJQ-të, të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë brenda Komunës së Rahovecit dhe që fushë veprimtari kanë kulturën, rininë dhe sportin. Në bazë të kësaj thirrjeje janë evidentuar 36 kërkesa nga OJQ-të, klubet sportive, shoqatat kulturore, organizatat rinore dhe individë të ndryshëm për mbështetje të botimit të librave. Komisioni ka konstatuar se 7 prej aplikuesve nuk i kanë plotësuar kriteret e aplikimit. Në planifikimet buxhetore komunale për vitin 2018 për këto aktivitete janë paraparë të ndahen 50 mijë euro nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Jemi të vetëdijshëm se shuma e përcaktuar është shumë e ulët për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e shumta, mirëpo ne kemi këto kufizime dhe në këtë kuadër duhet të mundohemi të përmbushim nevojat më themelore dhe projektet më të arsyeshme. Mirëpo, kjo nuk është e tëra, sepse tashmë janë krijuar kushte më të favorshme për sponsorizim, pas miratimit të rregullores për sponsorizim nga ana e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Po ashtu do të bëjmë përpjekje maksimale që klubet dhe individët e ndryshëm të

gjejnë mbështetje nga donatorë potencial. Ne sot po ju ofrojmë informatë publikut për zgjedhjen që ka bërë komisioni i posaçëm i ngritur për verifikimin e plotë të atyre që e kanë kërkuar ndihmën tonë.

Ju falënderoj për mirëkuptimin tuaj!

Ali Zhuniqi – I nderuari z. Afrim Dina drejtori njëherë e ceku që kanë të drejtë të aplikojnë të gjitha organizatat të cilat janë të licencuara nga Republika e Kosovës, pastaj e ceku se duhet të aplikojnë vetëm organizatat që operojnë brenda territorit të Komunës së Rahovecit. Kërkoj një sqarim nga ana e drejtorit po ashtu kishte me qenë mirë që drejtori të jetë i arsyeshëm dhe të na tregojë së paku se kush janë anëtarët e komisionit për ndarje të subvencioneve në mënyrë që të jemi më transparentë.

Ervin Hoxha – I nderuar z. Ali Zhuniqi OJQ- të që janë të regjistruara në Republikën e Kosovës por që aktivitetet e tyre i kryejnë në Komunën e Rahovecit, mundet të jetë OJQ-ja e regjistruar në Prishtinë por veprimtarin e kryen në Komunën e Rahovecit.

Isak Hoti – Siç e ceku edhe drejtori e kemi rregulloren e MF po ashtu edhe kuvendari z. Munib Durguti është në dijeni edhe e kemi obligative që në përputhje me këtë rregullore të ndahen të gjitha subvencionet në kategorinë e OJQ-ve, rregullorja është me numër 04/2017 ku mes tjerash udhëheqësi më i lartë administrativ siç e parasheh edhe rregullorja në këtë rast Kryetari i Komunës emëron një komision prej 5 anëtarëve me mandat për shqyrtimin e aplikacioneve konform rregullores për kushtet kriteret dhe ndarjen e subvencioneve. Përbërja e Komisionit kohëzgjatja dhe mandati i tij caktohet nga zyrtari kryesor administrativ në këtë rast kryetari i komunës, po ashtu përbëhet nga 5 anëtar nga fushat e ndryshme dhe të fushës përkatëse, kurse në paragrafin 7 të nenit 8 e ka parandaluar dhe e cekë: Anëtarët e Komisionit vlerësues nuk mundin të jenë anëtarë të emëruarit politikisht. Në nenin 9 parashihet edhe komisioni i ankesave brenda afatit sa është thirrja publike e hapur, këtu prapë kryetari e emëron një komision të ankesave dhe brenda 7 dite pas marrjes së vendimit publikohet në web faqe, afati i ankesave është prej 5 ditëve, komisioni i ankesave për shqyrtimin e ankesave. Kriteret, kushtet janë të përcaktuara konform rregullores të MF-së për kriteret dhe standardet e financimit publik të organizatave joqeveritare. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të ndahen subvencione të gjitha organizatave buxhetore të Republikës së Kosovës, përfshi komunat, ministrit dhe organizatat e tjera që kanë buxhet nga Republika e Kosovës.

Mirjeta Krasniqi – Përhëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket kësaj pike kisha kërkuar që të di pak më shumë rreth aktiviteteve të këtyre OJQ-ve, pastaj a kanë aktivitete apo janë OJQ vetëm për përfitime materiale, po ashtu dua ta di a zbatohen kriteret që ne i përmendëm, si do të ndahen mjetet, nga sa do të ndahen, po ashtu dua ta di a do të japin këta OJQ në fund llogari para Kuvendarëve për parat e shpenzuara. Ka shumë OJQ që në realitet janë inegzistente dhe vetëm për përfitime materiale e mbushin zarfin me disa dokumente. Prandaj kërkoj që të na vije lista e përfituesve në Kuvend dhe në fund të vitit të na raportojnë para kuvendit për shpenzimet e bëra.

Ali Morina – I nderuari Kryesues jam pro kësaj iniciative dhe gjithsesi që duhet të mbështetet OJQ-të të cilat mirën me aktivitete kulturore, rini dhe sport, pajtohem me parafolësen se duhet që të parashihen mirë aktivitetet e tyre të mëparshme si dhe të bëhet mbikëqyrja e plotë e implementimit të atyre projekteve të cilat janë përfitues, në rastin konkret tani që do të përfitojnë.

Kryetari – Të nderuar Kuvendarë besoj se rregullorja është e qartë dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet se si do të adresohen këto çështja nga fillimi e deri në fund. Pajtohem me ju që mundet të ketë OJQ fiktive, po ashtu duhet të pajtohem se komisioni i cili ka mare përgjegjësi që ta bëjë vlerësimin e secilit projekt, secilit program, adresim nga secila OJQ ka për detyrë që ta bëjë kujdesin e shtuar dhe sipas ligjit të i kryej punët e veta, po ashtu sipas ligjit OJQ-të edhe ato që përfitojnë nga buxheti i Komunës së Rahovecit në këtë raste në subvencione duhet të raportojnë në institucionet komunale, ju siguroj juve të gjithëve që do të publikohet lista e përfituesve nga

subvencionet e DKRS-së, ajo do të jetë në web faqe të Komunës dhe sigurisht se ne kemi me e dorëzue një informatë apo njoftim ose raport të komisionit në kuvend i cili ka përgjegjësin dhe sigurisht do të ketë një material edhe Kuvendi Komunal në kohën e duhur. Gjithsesi ne jemi të interesuar që paraja publike të menaxhohet në përputhje me ligjin për financa publike dhe financat e pushtetit lokal edhe unë si Kryetar Komune jam interesuar që OJQ-të përfituese dhe të gjitha OJQ-të tjera që janë në komunë të Rahovecit të kenë raportin e shpenzimeve. Sigurisht se do të ketë një komision i cili do të bëjë verifikimin e aktiviteteve të OJQ-ve përfituese.

Rasim Fazliu – Edhe ne jemi të pajtimit që të mbështeten të gjitha OJQ-të të cilat gjenden në Komunën e Rahovecit dhe që ushtrojnë veprimtarin, po ashtu pajtohem me kolegët që thanë që mirë është së pari të përkrahen ato OJQ-të që me të vërtet kanë aktivitete, të gjithë e dimë se mjetet janë mjaftë të kufizuara ne kemi përvojë edhe nga e kaluara, po ashtu e dimë që nuk do të dalin të kënaqur të gjithë. Por ato mjete të vogla apo të mëdha që i ndahen një OJQ-je është mirë që në fund të vitit të jepet llogari se ku i kanë shpenzuar në mënyrë që ne në fund të kemi një pasqyrë reale.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutimin e bërë, nëse jeni të pajtimit kalojmë në pikën e 6 të rendit të ditës:

6. Marrja e vendimit për Formimin e Komisionit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale.

Në këtë komision duhet të jenë 3 anëtar nga Kuvendi, 3 anëtar nga ekzekutivi dhe 1 anëtar nga shoqëria civile. Ja fillojmë me propozimet nga anëtarët e Kuvendit, si subjekt më i madh fjalën e ka PDK-ja.

Rasim Fazliu – I nderuari Kryesues ne si grupe i këshilltarëve të PDK-së për anëtar të Komisionit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale propozojmë z. Refki Kryeziu.

Ali Morina – Në grupi i AAK-së për anëtar të Komisionit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale propozojmë z. Artan Zenuni.

Fehmi Cena – Ne grupi i LDK-së për anëtar të Komisionit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale z. Masar Popaj.

Kryesuesi – Tani duhet që të propozohen 3 anëtar nga ekzekutivi, nëse i ka emrat Kryetari mundet që ti propozoj nëse nuk i ka tani mundet ti propozoj pas konsultave me ekipin e tij.

Kryetari – I nderuari Kryesues këta janë emrat nga ekzekutivi për anëtar të Komisionit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale: Afrim Oruqi, Afrim Limani dhe Saranda Sallteku.

Kryesuesi – A keni ndonjë propozim të ndonjë përfaqësuesi nga shoqëria civile.

Kryetari – Kishte me qen mirë që në këtë komision si anëtar i OJQ-së të përfshihet ndonjëri nga shoqatat e dala nga lufta apo nga shoqata e vreshtarëve ose enologjisë etj. Të nderuar Kuvendarë a jeni të pajtimit që këtë përgjegjësi të na lini neve që të zgjedhim një emër e pastaj ta përfshimë në vendim.

Kryesuesi – Po ju lexoj emrat e propozuar për anëtar të Komisionit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale. Nga PDK kemi z. Refki Kryeziu, nga AAK-ja kemi z. Artan Zenuni, nga LDK-ja kemi z. Masar Popaj, kurse nga radhët e ekzekutivit kemi: z. Afrim Limani, z. Afrim Oruqi dhe znj. Saranda Sallteku, kurse nga radhët e OJQ-ve u morëm vesh që këtë emër ta propozoj kryetari pas konsultimeve me ekipin e tij. I qes në votim emrat e propozuar për anëtar të Komisionit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale: Konstatoj se me 2 abstenime dhe asnjë kundër dhe të tjerët pronë janë aprovuar emrat e propozuar për anëtar të Komisionit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale. Kalojmë në pikën e radhës:

7. Marrja e vendimit për Formimin e Komisionit të Ankesave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale.

Në këtë komision duhet që të jenë 3 anëtar nga Kuvendi i Komunës, por duhet që të keni parasysh se duhet të i përmbaheni edhe kuotës gjinore. Fillojmë me propozimet, si gjithmonë fjalën e ka subjekti më i madh.

Rasim Fazliu – Ne grupi i PDK-së për anëtar të Komisionit të Ankesave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, propozojmë delegaten znj. Besmire Bytyçi.

Ali Morina – Ne grupi i AAK-së dhe Nismës për Kosovën për anëtar të Komisionit të Ankesave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, propozojmë z. Besnik Hoti.

Fehmi Cena – Nga grupi i LDK-së për anëtar të Komisionit të Ankesave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, propozojmë z. Faton Ramadani.

Kryesuesi – Të nderuar po ju lexoj emrat e anëtarëve të propozuar për formimin e Komisionin e Ankesave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale. PDK-ja propozon znj. Besmire Bytyçi, AAK dhe Nisma për Kosovën propozon z. Besnik Hoti, LDK-ja propozon z. Faton Ramadani. I qesim në votim këta emra të propozuar për formim të Komisionit të Ankesave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, propozojmë.

Munib Durguti – I nderuari Kryesues nuk mendoj se është e arsyeshme që anëtarët e subjektit të njëjtë të bëjnë kontrollimin e kolegëve të tyre për dhënien e pronës në shqyrtim, nëse nuk është e përcaktuar me ligj kështu atëherë propozoj që për këtë komision të ankesave të jenë anëtar ata të cilët nuk janë pjesë e subjektit që e përfaqësojnë komisionin e parë.

Kryesuesi – I nderuari z. Munib Durguti ju faleminderit por ne duhet që ti përmbahemi asaj që subjektet më të mëdha politike që përfaqësohen me më shumë kuvendar në kuvend duhet që ti formojnë këto komisione.

Rasim Fazliu – Mendoj se për të gjitha komisionet që i formuam është mirë që ne si kuvend të marrim edhe një vendim për pagesë ndaj punës që e kryejnë ata si anëtar të komisionit, në mënyrë që mos të kemi probleme, sepse çdo anëtar duhet që të le punën e vet dhe të vije me makinë private të bëjë shpenzime, prandaj propozoj që të kompensohet të gjithë anëtarët e çfarëdo komisioni që formohet.

Kryesuesi - I qes në votim emrat të propozuar për formim të Komisionit të Ankesave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, propozojmë: Konstatohet se me 5 abstencime, asnjë kundër dhe të tjerët pro miratohet Komisioni i Ankesave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale.

Kryetari – I nderuar z. Rasim Fazliu është një vendim për pagesë të mëditjeve për anëtarët e komisionit i cili është marrë nga anëtarët e KK-së të legjislacionit të kaluar, ne jemi pro asaj që të paguhet anëtarët e komisionit, ju nëse doni ta fuqizoni vendimin e mandatit të kaluar atëherë do e fuqizojmë edhe pse nuk është pikë e rendit të ditës, I nderuari Kryesues hidhe në votim propozimin e z. Rasim Fazliu.

Kryesuesi – Të nderuar a jeni të pajtimit që kjo të jetë si pikë shtesë e rendit të ditës, ju faleminderit.

8. Marrja e vendimit për pagesën e mëditjeve të gjithë anëtarëve të të gjitha Komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit,

E qes në votim propozimin e z. Rasim Fazliu që të merret një vendim për pagesën e mëditjeve të gjithë anëtarëve të të gjitha Komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës së: Konstatohet se me shumicë votash është aprovuar vendimi për pagesë e mëditjeve të gjithë anëtarëve të të gjitha Komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës. Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

9. Të Ndryshme.

Rexhep Oruqi – Kam një pyetje për Kryetarin, nënkryetarin dhe drejtorin e drejtorisë për financa, pse nuk na është paguar mëditja për mbledhjen e muajit të kaluar kur ne e kemi mbajtur një seancë të rregullt, mos

ndoshta nuk na keni paguar për arsye që nuk kemi marrë pjesë në mbledhje të jashtëzakonshme, apo ligji nuk e lejon që të bëhet pagesa, kisha kërkuar një sqarim.

Mirjeta Krasniqi – A ka mundësi dikush nga ekzekutivi të më jepe një informatë zyrtare sa i përket projektit të ujit të pijes për fshtrat Pastasel, Petkoviq, Polluzh, por konkretisht për fshatin Pastasel më intereson ku ka mbërrut projekti, kur do të kenë banorët e këtij fshati ujë të pijshëm, janë bërë disa punime gjatë mandatit të kaluar por banorët ende nuk kanë ujë të pijshëm. Po ashtu në projektin për kanalizim nuk është përfshi i gjithë fshati, pyetja ime është a do të vazhdoj ky projekt dhe a do të përfshihet i gjithë fshati apo ky projekt ka përfunduar me kaq.

Dervish Qadraku – Kjo pyetje më shumë vlen për Kryetarin e Komunës pasi sipas tij ai është mbi kuvendin, kisha pas dëshirë që ta di kur do të filloni ju si menaxhment udhëheqës dhe si Komunë ta trajtoni flamurin Kombëtar në mënyrë dinjitoze, nëpër festa të ndryshme vendosen flamuj dhe nëse dilni në rrugë do ti shihni se flamujt nëpër biznese janë të vendosur aq keq të shqyer të përlyer etj. Pra kur do të bëhet trajtimi i kësaj dukurie dhe të hyjë në binarë ashtu si duhet sepse ne vetë si popull Shqiptar nuk jemi në gjendje ta trajtojmë këtë problematik ku e gjitha bota e trajtojnë, është kompetencë e juaj si Kryetar i Komunës që mekanizmat që i keni të disiplinoni edhe individët por edhe subjektet sepse ne përmes këtij flamuri edhe identifikohemi si shqiptar dhe është për tu ardhur keq që askush deri më tani nuk është duke u marrë me këtë problematik.

Artan Zenuni – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një kërkesë për drejtorin e financave që në mbledhjen e ardhshme të na sjellë një raport për borxhet dhe obligimet kontraktuale nga qeverisja e kaluar, në mënyrë që ne të kemi një pasqyrë të qartë se sa ka obligime komuna jonë.

Kryetari – Lejohen nga pak edhe shakatë në kuvend, jam Kryetar i Komunës dhe jam i vetëdijshëm për përgjegjësitë që i kam por nganjëherë duhet të bëjmë edhe pak relaksim jam i kënaqur që e kemi kryer kaq shpejt këtë seancë, në disa raste ndoshta keni gabuar që nuk i keni kërkuar Kryesuesit z. Afrim Dina ndonjë pauzë. Jam Kryetar i Komunës nuk jam Kryesues i Kuvendit por ju siguroj të gjithëve se drejtorët e drejtorive komunale së bashku me Kryetarin e Komunës në çdo seancë të Kuvendit të Komunës përgjigjet me gojë dhe me shkrim sipas kërkesave tuaja ju siguroj që përgjigjet si me shkrim ashtu edhe me gojë do të i merrni me kohë. Sa i përket ujit të pijes dhe të gjitha çështjet të cilat janë me interes që u trajtuan sot këtu por edhe ato që nuk u trajtuan. Pyetjen që e parashtrroi z. Rexhep Oruqi, sa i përket çështjes së mëditjes të njëjtën pyetje ja kam bërë edhe unë drejtorit të financave z. Afrim Limani, ky është më shumë problem ligjor sesa ndonjë teke e Kryetarit të Komunës ose drejtorit të financave për mos pagesë të mëditjes, por sidoqoftë ju premtoj se nëse ka ndonjë mundësi ligjore jam pro asaj që ti bëhet pagesa kuvendarëve për mbledhjen e kaluar dhe besoj shumë shpejtë do të qartësohet gjithçka në mënyrë që mos ti mbesim borxh asnjë këshilltari. Nëse ka diçka ma shumë të shtoj drejtori i financave le të dele, unë po kërkoj që në pajtim me ligjin të mos i mbesim borxh asnjë anëtarit të Kuvendit. Anëtarët e Kuvendit Komunal duhet që të trajtohem më seriozisht si me pagesë ashtu edhe me shumë gjëra e tjera, e di se me 195.00 € është e pamundshme me qenë përfaqësues me integritet moral dhe me dinamika të larta si përfaqësues i zgjedhur i Kuvendit të Komunës, këtë çështje e kam ngritur edhe në vendet e tjera dhe kam than se anëtarët e Kuvendit Komunal paguhën shumë pak kurse nga ta kërkohet shumë. Pyetjen që e parashtrroi z. Dervish Qadraku, është e vërtetë ne kemi kërkuar nga operatori i cili ka kontratë me Komunën e Rahovecit, fillimisht që në të gjitha pllakat përkujtimore, varrezat e dëshmorëve dhe në objektet e tjera të vendosen flamujt ashtu siç duhet, mund të kemi pak probleme me protokollin sepse ndoshta se njohim mirë, ne në komunë po përpiqemi që ta trajtojmë pak më me seriozitet dhe pak më mirë këtë çështje sepse edhe unë jam i pakënaqur, kurse sa i takon sektorit privatë ose subjekteve private, mendoj se këtu është drejtori i inspektoratit mundet të analizojë ndonjë plan operativ që të ketë një vëmendja pak më të madhe institucionale po ashtu mendoj se është obligim i secilit i cili e vendos një flamur ta di se si po e vendos dhe ku po e vendos, me seriozitetin më të madhe unë e respektoj flamurin kombëtar por besoj se e respektojnë të gjithë, ne e respektojmë edhe flamurin shtetëror, në këtë festë ndoshta kemi pasur mungesa të flamujve shtetërorë për arsye se ne që një muaj e gjysmë e kemi marrë mandatin dhe mundemi të kemi probleme, dëshira jonë ka qenë që të gjitha vendbanimet dhe ambientet e frekuentuara të komunës sonë të

vendosen flamujt kombëtar dhe flamujt e shtetit, por mundësit reale nuk kanë qenë të bollshme që të ketë një atmosferë më të gjallë. Sa i përket seriozitetit të kësaj tema pajtohem plotësisht me z. Dervish Qadrakun që trajtimi i simboleve tona të jetë në vëmendjen tonë shumë ma shumë në të ardhmen, e besoj se ne do të jemi shumë më aktivë në të ardhmen.

Afrim Limani – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, pasi dola për herë të parë në këtë më lejoni që në këtë mandat 4 vjeçar të ju uroj shëndet dhe punë të mbarë. Sa i përket pyetjes së kuvendarit z. Rexhep Oruçi se pse i kanë munguar mëditjet për muajin janar, është shumë e vërtetë i nderuari kuvendar se mëditjet për muajin janar ju kanë munguar po e kam për obligim që të ju japë një njoftim se mëditjet për muajin janar do të merrni në muajin shkurt sepse sistemi në kuadër të MF divizioni për pagesa i cili i proceson më së largu deri me datë 11 të muajit aktual, kjo është arsyeja pse keni mbetur pa mëditje për muajin janar, ju garantoj se kjo mëditje nuk do të ju humbë dhe shpresoj se shumë shpejtë do ju dele në llogaritë tuaj. Kurse kuvendari i nderuar z. Artan Zenuni e patë një pyetje për një raport për borxhet e Komunës së Rahovecit për vitin 2017, i nderuari z. Artan Zenuni unë e kam përgatit dokumentacionin dhe në mbledhjen e ardhshme do të keni të gatshëm këtë dokument.

Ali Zhuniqi – I nderuari Kryesues e kam mare një shqetësim nga disa persona të cilët më kanë kontaktuar mua qoftë përmes telefonit ose përmes rrjeteve sociale, ka informata që në disa shkolla fillore të Komunës së Rahovecit përdorët alkooli, po ashtu profesorët e mbajnë alkoolin nëpër frigoriferë të shkollave, kjo pyetje shkon direkt për drejtorin e arsimit, nëse kjo që më kanë lajmëruar është e vërtetë dhe ka fakte atëherë kjo çështje duhet të merret shumë seriozisht sepse kjo reflekton tek nxënësit po ashtu mendoj se drejtoria e arsimit në këtë pikë duhet që të ndërmer hapa urgjente dhe kishte me qenë mirë që kjo të jetë edhe si pikë e rendit të ditës në ndonjë mbledhje të Kuvendit. Kam po ashtu informata se në disa shkolla fillore bëhet edhe përdorimi i duhanit nga disa arsimtarë, prandaj edhe kjo si çështje duhet që të merret shumë seriozisht po ashtu edhe inspektorati që funksionon në kuadër të komunës duhet të dele në teren dhe ti inspektojë këto shkolla.

Kryetari – Nuk është pretendim që ti përgjigjemi të gjitha pyetjeve sot ne do të ju përgjigjemi edhe me shkrim, ne kemi filluar aksionin e takimeve kushtimishtë emergjente nëpër shkollat e mesme dhe kemi krijuar komision të posaçëm për verifikimin dhe incizimin e gjendjes faktike dhe fizike të objekteve shkollore ky raporte thuajse është gati, ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë me policin e Kosovës, ne inkurajojmë të gjitha ata që kanë ide të mira kreative që të shtojnë bashkëpunimin në mënyrë që të rritet angazhimi në sferën e edukimit dhe ndjenjës së përgjegjësisë nëpër shkolla. Të nderuar kuvendar ju uroj 10 vjetorin e Pavarësisë së Republikës së Kosovës nga Serbia, lavdi dëshmorëve të kombit, shihemi në seancat e radhës.

Kryesuesi – Të nderuar Kuvendarë ju faleminderit për pjesëmarrje dhe për kontributin e dhënë, me kaq mbaron mbledhja e sodit shihemi në mbledhjet e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 12:20

Procesmbajtësi

Skender Hamza

K R Y E S U E S I

Afrim Dina